




Ndërtimi i Kapaciteteve Vendore dhe Bashkëpunimit të Strukturave të Zbatimit të Ligjit për Luftimin e Trafikimit të Paligjshëm të Trashëgimisë Kulturore Shqiptare

REKOMANDIME



Cultural Heritage without Borders Albania

2026



Si pjesë e projektit “Ndërtimi i Kapaciteteve Vendore dhe Bashkëpunimit të Strukturave të Zbatimit të Ligjit për Luftimin e Trafikimit të Paligjshëm të Trashëgimisë Kulturore Shqiptare”, Cultural Heritage without Borders Albania (CHWB Albania) ka fokusuar përpjekjet e saj në krijimin e kushteve për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve dhe forcimin e angazhimit për parandalimin e trafikimit të paligjshëm të objekteve të trashëgimisë kulturore. Kjo është në përputhje me Objektivin 1 të projektit: Forcimi i bashkëpunimit dhe angazhimit të aktorëve për të parandaluar trafikimin e paligjshëm të objekteve të trashëgimisë kulturore, me fokus të veçantë në rritjen e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e koordinimit ndër-institucional dhe nxitjen e përpjekjeve të përbashkëta ndërmjet aktorëve kyç të përfshirë në mbrojtjen e pronës kulturore në të gjithë vendin.

Si një aktivitet kryesor në kuadër të këtij objekti, CHWB Albania organizoi një seri prej katër tryezash të rrumbullakëta, të mbajtura ndërmjet shtatorit dhe dhjetorit 2025 në katër qytete të ndryshme të Shqipërisë: Gjirokastrë, Fier, Shkodër dhe Korçë. Këto tryeza u konceptuan si platforma gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar, duke bashkuar përfaqësues nga organet e zbatimit të ligjit, institucionet e trashëgimisë kulturore, autoritetet doganore, pushteti vendor, shoqëria civile dhe aktorë të tjerë relevantë. Duke i zhvilluar diskutimet në rajone të ndryshme, projekti siguroi që perspektivat lokale, realitetet operacionale dhe sfidat specifike rajonale të pasqyroheshin në mënyrë domethënëse krahas prioriteteve në nivel kombëtar.

Secila tryezë ndoqi një metodologji të përbashkët. Ekipi i projektit prezantoi objektivat e përgjithshme dhe fushëveprimin e nismës, ndërsa ekspertë të përzgjedhur paraqitën kërkime, të dhëna dhe analiza kontekstuale lidhur me trafikimin e paligjshëm të objekteve të trashëgimisë kulturore. Moderator i tryezave lehtësoi një dialog të hapur dhe konstruktiv ndërmjet pjesëmarrësve, duke inkurajuar shkëmbimin e përvojave, identifikimin e praktikave të mira dhe diskutimin e sinqertë të sfidave të hasura në praktikën e përditshme profesionale. Vëmendje e veçantë iu kushtua boshllëqeve në legjislacion, koordinim, shkëmbim informacioni, mandate institucionale dhe zbatimin e kuadrove ekzistuese.

Këto konsultime nuk u konceptuan si aktivitete të izoluara, por si një proces i vazhdueshëm që synonte gjenerimin e rezultateve konkrete dhe të zbatueshme. Përmes këtyre diskutimeve, aktorët identifikuan së bashku nevojat, prioritetet dhe mundësitë për përmirësimin e bashkëpunimit, duke reflektuar njëkohësisht mbi hapa praktikë që mund të forcojnë zbatimin e politikave ekzistuese. Gjetjet e mbledhura gjatë katër tryezave u dokumentuan në mënyrë sistematike, u analizuan dhe u konsoliduan nga ekipi i projektit.

Ky dokument paraqet rekomandimet e përmbledhura që dalin nga katër tryezat e rrumbullakëta dhe konsultimet shoqëruese me aktorët kyç në nivel lokal dhe kombëtar.



Këto rekomandime përfaqësojnë një produkt kolektiv të procesit pjesëmarrës dhe pasqyrojnë angazhimin e përbashkët të institucioneve të përfshira për të përmirësuar koordinimin, për të forcuar kapacitetet dhe për të rritur efektivitetin e reagimit të Shqipërisë ndaj trafikimit të paligjshëm të objekteve të trashëgimisë kulturore. Ato synojnë të mbështesin përpjekjet në vijim dhe të ardhshme të autoriteteve kombëtare dhe partnerëve, si dhe të informojnë ndërhyrjet e mbështetura nga donatorët për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë në mënyrë të qëndrueshme dhe të koordinuar.

Rekomandimet janë grupuar në shtatë kategori, si më poshtë:

I. Ngritja e Kapaciteteve Institucionale, Trajnimi dhe Ekspertiza

- i. Hartimi i manualeve operacionale për trajtimin e rasteve të trafikimit të objekteve të trashëgimisë kulturore.
- ii. Përfshirja e ekspertëve të muzeve, arkeologëve dhe specialistëve të ndryshëm të fushës në proceset hetimore, si dhe në shërbimet e policisë dhe doganave.
- iii. Trajnime të specializuara për policinë, prokurorinë dhe gjykatat mbi identifikimin e objekteve të trashëgimisë kulturore.
- iv. Organizimi i trajnimeve dhe ushtrimeve të specializuara të përbashkëta për stafin e angazhuar në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të trashëgimisë kulturore, brenda vendit dhe në institucione homologe jashtë vendit, me qëllim përfitimin e njohurive të avancuara, praktikave më të mira ndërkombëtare dhe forcimin e kapaciteteve profesionale në parandalimin, identifikimin dhe ndjekjen penale të rasteve të trafikimit. Përfshirë përdorimin e teknologjive digjitale (skanim 3D, baza të dhënash vizuale, inteligjencë artificiale për krahasimin e imazheve).
- v. Punësimi i individëve me formim në fushën e trashëgimisë kulturore në institucione si doganat, prokuroria dhe policia, si dhe punësimi i individëve me formim në siguri në sitet arkeologjike dhe muze.

II. Koordinimi Ndërinstitucional dhe Mekanizmat e Qeverisjes

- i. Krijimi i një grupi pune ndërinstitucional në rajone – një task-forcë e dedikuar për luftën kundër trafikimit të trashëgimisë kulturore.
- ii. Organizimi i takimeve më të shpeshta me të gjithë aktorët.
- iii. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të trashëgimisë dhe policisë për ndarjen e përgjegjësive, në përputhje me ligjin, dhe për ndjekjen e rasteve të raportuara.
- iv. Vendosja e procedurave të përhershme të koordinimit ndërmjet Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit (MTKS) dhe Policisë së Shtetit, Doganave dhe Prokurorisë.
- v. Përfshirja e tematikës në punën e Këshillave të Sigurisë në Komunitet.
- vi. Një platformë online koordinimi për shkëmbimin e informacionit në kohë reale ndërmjet institucioneve.



III. Kuadri Ligjor dhe Zbatimi i Politikave

- i. Rishikimi dhe përmirësimi i legjislacionit për trashëgiminë kulturore dhe Kodin Penal.
- ii. Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me konventat ndërkombëtare (UNESCO 1970, Konventa e Nikozias).
- iii. Ndryshimi i Kodit Penal për të përfshirë gërmimet e paligjshme si vepër penale.
- iv. Zbatimi i planit strategjik të MTKS kundër trafikimit dhe implementimi i marrëveshjes së nënshkruar me qeverinë e SHBA-së për luftën kundër trafikimit të trashëgimisë kulturore.
- v. Miratimi i Plan Veprimit lidhur me Planin Strategjik të MTKS.
- vi. Miratimi i Plan Veprimit lidhur me Marrëveshjen për Pronën Kulturore.
- vii. Krijimi i një inspektorati për monitorimin e trafikimit dhe dëmtimit të trashëgimisë kulturore.
- viii. Hartimi i udhëzuesve praktikë ligjorë për policinë dhe prokurorinë mbi procedurat e sekuestrimit dhe kthimit të objekteve.
- ix. Krijimi i një baze të dhënash ligjore me rastet e mëparshme të trafikimit për të mbështetur vendimmarrjen gjyqësore.

IV. Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe Shkëmbimi i Informacionit

- i. Forcimi i bashkëpunimit me INTERPOL-in, EUROPOL-in dhe rrjetet rajonale.
- ii. Përdorimi aktiv i bazave ndërkombëtare të të dhënave për objektet e vjedhura.
- iii. Marrëveshje dypalëshe me vendet fqinje për shkëmbimin e informacionit mbi trafikimin.

V. Inventarizimi, Dokumentimi dhe Sistemet Digjitale

- i. Inventarizimi dhe digjitalizimi i aseteve kulturore në nivel lokal, përfshirë muzetë bashkiakë dhe privatë, si dhe koleksionet, dhe Institutin e Arkeologjisë.
- ii. Mundësimi i aksesit për institucionet e zbatimit të ligjit në bazën kombëtare të të dhënave.
- iii. Standardizimi i sistemit të menaxhimit të inventarit dhe integrimi me bazat ndërkombëtare të të dhënave, duke mundësuar gjurmimin dhe identifikimin.
- iv. Përdorimi i teknologjisë blockchain për gjurmimin e origjinës së objekteve të trashëgimisë kulturore.
- v. Krijimi i një platforme ku të regjistrohen të gjitha informacionet mbi objektet e vjedhura/humbura përpara se t'i përcillen policisë apo INTERPOL-it.
- vi. Hartimi i një liste të objekteve “të humbura” nga komunitetet fetare.
- vii. Monitorimi i veprimtarisë tregtare lidhur me objektet artistike dhe historike.
- viii. Përditësimi i vlerës monetare të objekteve të inventarizuara.



VI. Mbrojtja, Ruajtja dhe Menaxhimi i Siteve

- i. Sigurimi i kushteve të përshtatshme për ruajtjen e objekteve të sekuestruara në nivelin e Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore.
- ii. Hartimi i planeve të menaxhimit të riskut në lidhje me aktivitetet e paligjshme për çdo sit të trashëgimisë.
- iii. Vendosja e sinjalistikës paralajmëruese dhe informuese në sitet e trashëgimisë.
- iv. Instalimi i sistemeve të alarmit, kamerave të survejimit dhe masave të tjera të sigurisë në sitet e trashëgimisë.
- v. Përfshirja e Formularit të Vetëvlerësimit të Nivelit të Sigurisë për Pasuritë Kulturore në raportimet periodike të MTKS.

VII. Ndërgjegjësimi Publik, Edukimi dhe Angazhimi i Komunitetit

- i. Fushata informuese për komunitetet lokale mbi rëndësinë e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në shkolla dhe në media.
- ii. Nisma për të inkurajuar qytetarët të raportojnë raste të dyshimta.
- iii. Krijimi i një linje telefonike të dedikuar për raportimin e rasteve të trafikimit të paligjshëm.
- iv. Përfshirja e komuniteteve lokale në patrulla vullnetare për mbrojtjen e siteve arkeologjike, si dhe inkurajimi i punësimit të tyre në sitet e trashëgimisë, veçanërisht në ato të vendosura në zona të thella apo të izoluara.
- v. Koordinimi ndërmjet institucioneve akademike për organizimin e sesioneve të hapura për shkëmbimin e njohurive.
- vi. Programe ndërgjegjësimi dhe stimuluese për regjistrimin e objekteve që mbahen nga koleksionistë privatë.

Deklarata e përgjegjësisë

Ky dokument është hartuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Kapaciteteve Vendore dhe Bashkëpunimit të Strukturave të Zbatimit të Ligjit për Luftimin e Trafikimit të Paligjshëm të Trashëgimisë Kulturore Shqiptare”, i zbatuar nga CHWB Albania me mbështetje financiare nga Cultural Property Agreement Implementation Grant Program (CPAIG), i ofruar nga Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përmes Ambasadës së SHBA-së në Shqipëri, dhe është i destinuar vetëm për përdorim nga sitet dhe institucionet pjesëmarrëse. Çdo riprodhim, shpërndarje ose ripërdorim i përmbajtjes së tij, përfshirë tekstin dhe imazhet, pa pëlqimin paraprak me shkrim të autorëve, nuk lejohet.

Opinionet, gjetjet dhe përfundimet e shprehura në këtë dokument janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.